

Padia kolektive nuk përjashton të drejtën e padisë individuale!

Projektligji parashikon mekanizma nëpërmjet të cilave çdo person i cili vlerëson se mund t'i mbrojë interesat e tij në mënyrë individuale, ka të drejtë të përjashtohet nga padia kolektive dhe efektet e saj.

Disa raste hipotetike kur mund të ngrihet një padi kolektive:

- Keni blerë një produkt kozmetik për lëkurën tuaj, i cili ju ka shkaktuar efekte anësore pavarësisht se produkti marketohet si i testuar dermatologjikisht. Kjo ka sjellë për ju shpenzime shtesë për mjekimet e efekteve anësore, si dhe ju ka zhgenjyer për rezultatet që prisnit nga produkti. Të njëjtën problematikë e kanë hasur dhe konsumatorë të tjerë.
- Keni konsumuar një darkë në një nga restorantet më luksoze të qytetit. Disa orë pas darkës nuk jeni ndjerë mirë dhe jeni drejtuar kujdesit shëndetësor. Aty ju zbuloni se jeni helmuar nga ushqimi që keni konsumuar në restorant. Helmimi ka shkaktuar ndërlikime në shëndetin tuaj. Të njëjtën eksperiencë e kanë përjetuar dhe klientët e tjerë të restorantit në atë mbrëmje.
- Konstatoni se Banka juaj ka nisur aplikimin e një komisioni bankar të pajustificuar sipas kuadrit ligjor bankar dhe për të cilin nuk ka marrë miratimin tuaj.
- Jeni të punësuar në një ndërmarrje me një staf prej 50 personash dhe punëdhënësi ju detyron të punoni orë shtesë të pa paguara.
- Jeni banorë të një zone në të cilën një fabrikë prodhimi për shkak të veprimtarisë prodhuese të saj lëshon një sasi të madhe tymi në ajër, gjë që ka sjellë një ndotje të madhe të mjedisit duke dëmtuar dhe shëndetin tuaj.


Përgatitur nga CR Partners në kuadër të Projektit "Propozimi i projektligjit "Për Paditë Kolektive" – një instrument ligjor i munguar në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve."

Mbështetur nga



Instrumenti i Padisë Kolektive

Një risi në mbrojtjen e të drejtave të individëve



Instrumenti i Padisë Kolektive

Një Risi në Mbrojtjen e të Drejtave të Individëve

Ngritja e një padie në Gjykatë shoqërohet me shpenzime të shumta dhe kërkon një angazhim jo të vogël kohor. Arsyeja e vetme që do të nixte një person për të filluar një proces të tillë dhe për të paditur dikë është vetëm nëse dëmet që personi ka pësuar janë të konsiderueshme, si në rastet e dëmtimeve të rënda fizike ose humbjeve financiare.

**100.000
Lekë** dëm




Por, nëse dëmi arrin në vlerën rreth 100.000 Lekë apo 10.000 Lekë a ia vlen të ngrini një padi individuale në Gjykatë?

Për shumicën e njerëzve, përgjigjja është jo.

Vërehet se ndërmarrjet me pozita të favorshme në treg shpesh kryejnë shkelje ligjore në dëm të individëve të një grupi të caktuar. Këtu mund të përmendim shkeljet e evidentuara nga operatorë të industrisë bankare, të telekomunikacionit, të tregtisë dhe shërbimit në industrinë ushqimore dhe jo-ushqimore. Trajtimi individual i këtyre shkeljeve nuk ka pasur ndonjë efekt, për të mos thënë që çdo përpjekje individuale ka rezultuar e dështuar për shkak të pafuqisë që mbart individi përkundrejt ndërmarrjeve të cilat gëzojnë një mbështetje dhe mbrojtje me të madhe, falë burimeve financiare dhe logjistike, por dhe për shkak të pozitës së tyre në treg.

Anëtare të ndryshëm të shoqërisë civile kanë bërë hulumtimet e tyre për të gjetur mjetin ligjor më të përshtatshëm dhe efikas për të shmangur dhe luftuar këto praktika të padrejta në dëm të grupeve të individëve. Në fund të këtij hulumtimi, është arritur në konkluzionin se **propozimi dhe miratimi nga Parlamenti i ligjit për paditë kolektive është mjeti i duhur për këtë qëllim.**

Çfarë është padia kolektive?



Sipas projektligjit që synohet të propozohet nga qytetarët, padia kolektive është një mjet ligjor nëpërmjet së cilit një organizatë jo-fitimprurëse mund të ngrejë një padi në Gjykatë në emër të një grupi personash të dëmtuar, për të përfituar dëmshpërblim për veprimet e paligjshme të një ndërmarrje të caktuar.

OJF-ja që legjitimohet të paraqesë këtë lloj padie, duhet të ketë përmbushur një sërë kriteresh ligjore të cilat garantojnë transparencën dhe ndalimin e abuzimit me këtë të drejtë nga OJF-të të cilat mund të influencohen nga ndërmarrjet ndaj të cilave mund të ngrihen paditë kolektive.

Padia kolektive i garanton aksesin në Gjykatë të gjithë individëve që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të nisur një proces gjyqësor për dëmet që i shkaktohen nga ndërmarrje të ndryshme, ose atyre që i duket me interes të vogël investimi në një proces të ndërlikuar dhe të gjatë.

Dy premisat kryesore për ngritjen e një padie kolektive janë: ekzistenca e një veprimi të paligjshëm të një subjekti dhe veprimi t'i ketë sjellë dëme një numri të konsiderueshëm personash.

Cilat janë dobitë e padisë kolektive?

Shmang ngritjen e disa padive individuale për të njëjtin veprim të paligjshëm të një ndërmarrje;

Realizon interesat e një grupi të madh individësh, pa shpenzime monetare dhe kohore për ta;

Mundëson që të gjithë individët e dëmtuar nga një sjellje e paligjshme e një ndërmarrje që ofron mallra ose shërbime, ose nga punëdhënësit, të dëmshpërblehen pa pasur nevojë që të ngrejë personalisht një padi në Gjykatë;

Ndihmon në uljen e ngarkesës së Gjykatave, duke mundësuar afate më të shkurtra kohore për përfundimin e procesit gjyqësor.